

V E N D I M
Nr.323, datë 14.6.1993

**PËR KALIMIN E INSTITUCIONEVE FËMINORE (ÇERDHEVE) NË ADMINISTRIM TË
PUSHTETIT LOKAL**

Me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Institucionet fëminore (çerdhet) të kalojnë në administrim të organeve të pushtetit lokal, bashkive dhe komunave, sipas juridiksionit.
2. Ndërtesat, anekset e shërbimit, inventari, personeli tekniko-administrativ dhe i gjithë fondi i nevojshëm për funksionimin e këtyre institucioneve t'i kalojnë organeve të pushtetit lokal, në juridiksionin e të cilave ndodhen këto institucione.
3. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë të përcaktojnë fondet dhe të bëjnë kalimin e tyre organeve të pushtetit lokal brenda datës 1.9.1993.
4. Ndërtesat e institucioneve fëminore (çerdhet) që me vendim të drejtorive të shëndetit publik të rretheve, deri në daljen e këtij vendimi, janë kthyer në institucione për nevojat e shërbimit shëndetësor shtetëror, të vazhdojnë të përdoren për këtë destinacion dhe vendimet përkatëse që janë marrë për to, të konsiderohen të vlefshme.
5. Të gjitha veprimet juridike të kryera në këto objekte, që janë në kundërshtim me këtë vendim, konsiderohen të pavlefshme.
6. Aktet nënligjore që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.9.1993.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi